



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE

PROCESVERBAL
KOMITETI SEKTORIAL I MIKPRITJES DHE TURIZMIT

RENDI DITËS:

1. Mirëseardhja, fjala hapëse dhe prezantimi i agjendës së aktivitetit

Takimi u hap nga **znj. Ejvis Gishti**, e cila falenderoi anëtarët për pjesëmarrjen dhe angazhimin e vazhdueshëm për t'iu bashkuar takimeve, sidomos në periudhën më intensive të sezonit. Ajo tha se takimi do të përqëndrohej tek diskutimi i standardeve të profesioneve dhe kualifikimeve profesionale që Agjencia ka përgatitur gjatë vitit 2024 për fushën e hoteleri - turizmit. Takimi do të përqëndrohej tek diskutimi i komenteve që anëtarët mund të kishin për dokumentat duke qenë se, ato ishin vënë në dispozicion të anëtarëve disa javë më përpara.

Fjala i kaloi **z. Rahman Kasa**, i cili falenderoi anëtarët për pjesëmarrjen dhe iu uroi një sezon të mbarë. **Z. Kasa** tha se nga çfarë kishte parë nga materialet dhe nga informacioni që mori për grupet hartuese, standardet ishin brenda pritshmërive të biznesit. **Z. Kasa** tha se të gjitha profesionet e hartuara janë shumë të rëndësishme për sektorin e turizmit dhe se puna e Agjencisë është për tu vlerësuar për ofertën që përgatit.

2. Validimi i standardeve të profesioneve

Në vijim të agjendës, **znj. Aleksandra Kole**, u shpjegoi anëtarëve se si është procesi i hartimit të dokumentave që Agjencia realizon. Të gjitha dokumentat hartohen dhe më pas validohen nga grupe ekspertësh të fushës përkatëse. Agjencia realizon vetëm koordinimin dhe orientimin e grupit mbi metodologjinë e përdorur dhe janë ekspertët që realizojnë gjithë përmbajtjen e dokumentacionit. **Znj. Kole** tha se, fillimisht do të nisnim me prezantimin e standardeve të profesioneve dhe më pas standardet e kualifikimeve profesionale, meqë kjo është rruga që ndjek hartimi i dokumentave.

Standardet e profesioneve përbëhen nga funksionet, detyrat, njohuritë dhe kriteret e performancës për çdo profesion. Për çdo standard profesioni ka disa detyra dhe funksione që janë thuajse të ngjashme si: planifikimi dhe organizimi i punës, komunikimi në mënyrë etike, ngritja e nivelit profesional, zbatimi i rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit apo kryerja e detyrave administrative dhe financiare në rast se, do të jetë i vetëpunësuar. Për këtë arsye, duke qenë se, volumi i dokumentave është i madh, prezantimi do të përqëndrohet tek detyrat profesionale për çdo profesion.

Për standardin e profesionit: *“Menaxher i mesëm në struktura akomoduese”*, **z. Fatos Cerenishti** tha se si konceptim dokumenti iu duk mirë i hartuar dhe në përmbushje të kërkesave që biznesi kishte. **Znj. Gishti** shtoi se, kurrikula e këtij profesioni, është kurrikula e parë pas të mesme që do të ofrohet sipas modalitetit dual dhe 70% e saj do të realizohet tek biznesi. Standardi u kalua pa ndryshime.

Standardi i profesionit: *“Kamariet-banakier”* kaloi pa komente.

Për standardin e profesionit: *“Operator turistik”*, **z. Elton Orozi** tha se, kur flasim për operator turistik, flasim për një subjekt ekonomik pra nuk mund të flasim për një profesion. Tek një operator turistik mund të ketë një menaxher, mund të ketë një ekspert të tregut. **Znj. Kole** shpjegoi se, për çdo profesion që hartohet, gjendet kodi përkatës tek Lista Kombëtare e Profesioneve. Tek Lista Kombëtare e Profesioneve kodi i operatorit turistik përfshin në nënndarje agjentin turistik, menaxherin etj. Që të ishte më gjithëpërfshirës si profesion është vendosur titulli i grupit të madh. **Z. Orozi** propozoi që mund të vendosen me footnote se çfarë përfshihet brenda grupit të operatorit turistik. **Z. Kasa** propozoi që mund të quhej *“Menaxher i mesëm në operator turistik”* ose *“Menaxher i mesëm në agjenci turistike”*. Për pjesën përmbajtësore nuk pati ndryshime.

Për standardin e profesionit: *“Nëpunësit e guidave turistike”*, **znj. Kole** shpjegoi se i është vendosur ky titull për shkak të referencës me Listën Kombëtare të Profesioneve, por kur të bëhet rishikimi i Listës do të quhet me titullin *“Udhërrëfyes turistik”*. Për pjesën përmbajtësore nuk pati ndryshime.

Standardet e profesioneve: *“Receptionist në hotel”* dhe *“Pasticier”* kaluan pa komente.

Për standardin e profesionit: *“Punonjës i kualifikuar në hotel dhe restaurant”*, duke qenë se është një profesion që ka në fokus bujtinat ose agroturizmat, në të cilat një punonjës mund të kryejë disa shërbime u propozua që mund dhe të quhet: *“Punonjës i kualifikuar për struktura akomoduese dhe ushqimi”*. Por, anëtarët ranë dakord të mendonin edhe njëherë titullin që mund të ketë.

3. Validimi i standardeve të kualifikimeve profesionale

Në vijim u vazhdua me diskutimin e standardeve të kualifikimeve të cilat mbështeten mbi standardet e profesioneve, që u diskutuan më përpara. Të gjitha kualifikimet profesionale janë të zhvilluara me rezultate të nxëni, por të grupuara me njësi të nxëni. Njësitë e të nxënit mund të përdoren dhe si kualifikime për kurse afatshkurtra. Standardet e kualifikimit ndërtohen mbi bazën e njohurive, shprehive dhe me ndryshimin që pësoi modeli i standardit të kualifikimit në 2024, ai përmban dhe kriteret e vlerësimit, si dhe modalitetet e vlerësimit.

Standardet e kualifikimit: “*Bar-restorant*”, niveli III në KSHK, “*Hoteleri*”, niveli III në KSHK (EHL), “*Kuzhinë*”, niveli III në KSHK (EHL), “*Shërbime ushqimi dhe pije*”, niveli III në KSHK (EHL), “*Menaxhim i strukturave akomoduese*”, niveli V në KSHK, “*Shërbime udhëtimi dhe turizmi*”, niveli IV në KSHK, “*Guidë turistike*”, niveli IV në KSHK, “*Reception*”, niveli III në KSHK, “*Pastiçeri*”, niveli III në KSHK dhe “*Shërbime në hotel dhe restorant*”, niveli III në KSHK kaluan pa komente.

Gjithsesi, anëtarëve ju la dhe disa ditë kohë që mund t’i shikonin sërish dokumentat dhe të përcillnin komente të tjera me email (në rast se kishin).

4. Përcaktimi i agjendës për mbledhjen e ardhshme dhe fjala përmblyëse

Në mbyllje të një takimi të gjatë, **znj. Gishti** tha se, herës tjetër anëtarët mund të diskutonin mbi rezultatet e nxjerra nga SNA dhe për propozimet që ata mund të kenë për rishikime të kualifikimeve ekzistuese ose propozime për kualifikime të reja. Gjithashtu, në takimin e radhës mund të diskutohet mbi rezultatet e vizitës studimore të kryer në zonën e Italisë së jugut, në qershor. një element tjetër i rëndësishëm për t’u diskutuar është rritja e mbështetjes së biznesit ndaj shkollave, si një çështje parimore dhe shumë të rëndësishme.

➤ Vendime të marra nga mbledhja:

- U validuan pa ndryshime standardet e profesioneve: “*Menaxher i mesëm në struktura akomoduese*”, “*Kamarier-banakier*”, “*Receptionist në hotel*”, “*Punonjës i kualifikuar në hotel dhe restorant*” dhe “*Pastiçeri*”.
- U propozua ndryshimi i titullit për standardin e profesionit: “*Operator turistik*” në “*Menaxher i mesëm në operator turistik*” dhe përmbajtja u validua pa ndryshime.
- U propozua ndryshimi i titullit për: “*Nënpunës i guidave turistike*” në “*Udhërrëfyes turistik*” dhe përmbajtja u validua pa ndryshime.
- U validuan pa ndryshime standardet e kualifiimeve profesionale: “*Menaxhim i*

strukturave akomoduese”, niveli V në KSHK, “*Bar - Restorant*”, niveli III në KSHK, “*Shërbime udhëtimi dhe turizmi*”, niveli IV në KSHK, “*Guidë turistike*”, niveli IV në KSHK, “*Reception*”, niveli III në KSHK, “*Pastiçeri*”, niveli III në KSHK, “*Shërbime në hotel dhe restorant*”, niveli III në KSHK, “*Hoteleri*”, niveli III në KSHK, “*Kuzhinë*”, niveli III në KSHK dhe “*Shërbime ushqimi dhe pije*”, niveli III në KSHK.